

#### 4 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve të Pafajshëm - Viktima të Agresionit

"Fëmijët kanë të drejta. Fëmijët duan paqe."

Ky mesazh i thjeshtë, por i fuqishëm jehon në të gjithë botën me rastin e 4 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare e Fëmijëve të Pafajshëm - Viktima të Agresionit. Nuk është vetëm një mesazh shprese, por edhe një përkujtim se pas çdo statistike qëndron jeta e një fëmije, frika e një fëmije, loti i një fëmije dhe ëndrra e një fëmije që nuk duhej të ishte ndërprerë.

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve të Pafajshëm - Viktima të Agresionit u themelua nga Kombet e Bashkuara në vitin 1982 si një shprehje e shqetësimit për vuajtjet e fëmijëve të prekur nga konfliktet e armatosura. Sot, më shumë se katër dekada më vonë, rëndësia e saj është edhe më e madhe. Në një kohë kur luftërat, krizat humanitare, migrimet e detyruara dhe dhuna janë ende prezente në pjesë të ndryshme të botës, miliona fëmijë vazhdojnë ta paguajnë çmimin më të lartë për konfliktet që nuk i krijuan dhe që nuk i kuptojnë.

Për shumë fëmijë sot fjala "shtëpi" nuk do të thotë siguri. Fjala "shkollë" nuk do të thotë mësim. Ndërsa fjala "fëmijëri" nuk do të thotë gjithmonë lojë dhe hare.

Disa fëmijë zgjohen me tingujt e sirenavë në vend të zërave të prindërve të tyre. Të tjerë e kalojnë fëmijërinë e tyre në kampe refugjatësh, larg shtëpive, miqve dhe shkollave të tyre. Mijëra fëmijë jetojnë çdo ditë me frikën e dhunës, abuzimit, diskriminimit dhe neglizhencës. Fëmijëria e tyre nuk është e mbushur me momente të qeta, por me pasiguri dhe një luftë për siguri.

Të dhënat globale të sotme janë shqetësuese: më shumë se 468 milionë fëmijë jetojnë në zona konflikti dhe mbi 36 milionë fëmijë janë të zhvendosur nga lufta, dhuna dhe krizat. Këto shifra janë një kujtesë se miliona fëmijë vazhdojnë të rriten në kushte që kërcënojnë shëndetin, sigurinë dhe të ardhmen e tyre.

Pasojat e agresionit tek fëmijët nuk janë gjithmonë të dukshme. Përveç lëndimeve fizike ka edhe trauma të thella psikologjike që mund të mbeten të pranishme për vite me radhë. Frika, ankthi, ndjenjat e pasigurisë, humbja e të dashurve dhe ndërprerja e arsimit lënë gjurmë që ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

Prandaj, mbrojtja e fëmijëve nuk duhet të kufizohet vetëm në sigurimin e sigurisë fizike. Ajo përfshin gjithashtu krijimin e kushteve për zhvillim të shëndetshëm psikologjik, akses në arsim, kujdes shëndetësor, mbështetje emocionale dhe mundësinë që çdo fëmijë të rritet në një mjedis të mbushur me respekt, kujdes dhe mirëkuptim.

Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara numri i shkeljeve të rënda të të drejtave të fëmijëve në zonat e konfliktit mbetet alarmant. Vrasjet, gjymtimet, rekrutimi me forcë, rrëmbimet, dhuna seksuale, sulmet ndaj shkollave dhe spitaleve dhe kufizimet në ndihmën humanitare vazhdojnë të jenë një realitet i ashpër për shumë fëmijë në mbarë botën.

Por kjo ditë nuk është vetëm për fëmijët e prekur nga lufta. Ajo flet edhe për çdo fëmijë që është viktimë e dhunës në familje, neglizhencës, ngacmimit, abuzimit ose përjashtimit social. Agresioni vjen në shumë forma. Nuk vjen gjithmonë me armë. Ndonjëherë vjen përmes fyerjeve, kërcënimeve, neglizhencës ose heshtjes. Kjo është arsyeja pse lufta për t'i mbrojtur fëmijët fillon në çdo shtëpi, çdo shkollë dhe çdo komunitet.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm - Viktima të Agresionit, Instituti i Shëndetit Publik e shënon këtë ditë dhe u bashkohet përpjekjeve globale për ngritjen e ndërgjegjësimit për nevojën e mbrojtjes së të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve. Duke promovuar mjedise të shëndetshme dhe të sigurt për rritje dhe zhvillim, duke e parandaluar dhunën dhe duke e përmirësuar shëndetin mendor tek fëmijët dhe të rinjtë, Instituti e thekson rëndësinë e mbështetjes dhe kujdesit në kohë për çdo fëmijë.

Mesazhi i këtij viti na bën thirrje t'i dëgjojmë fëmijët. Jo vetëm kur qajnë, por edhe kur heshtin. Jo vetëm kur kërkojnë ndihmë, por edhe kur përpiqen të jenë të guximshëm. Fëmijët kanë të drejtë të dëgjohen, të mbrohen dhe të respektohen. Të drejtat e tyre nuk duhet të varen nga vendi ku kanë lindur, gjuha që flasin apo rrethanat në të cilat jetojnë.

Një shoqëri matet nga mënyra se si i trajton anëtarët e saj më të cenueshëm. Prandaj, është përgjegjësia jonë e përbashkët të krijojmë një mjedis në të cilin çdo fëmijë ndihet i sigurt, i pranuar dhe i vlerësuar. Një mjedis në të cilin një fëmijë ka mundësinë të mësojë, të zhvillohet, të bëjë miq dhe ta ndërtojë të ardhmen e tij pa frikë.

Në këtë ditë ne nuk i kujtojmë vetëm fëmijët që kanë vuajtur. Ne e riafirmojmë angazhimin tonë për fëmijët që jetojnë sot dhe për brezat që do të vijnë. Të mos lejojmë që të drejtat e fëmijëve të mbeten vetëm fjalë të shkruara në dokumente dhe konventa. Le t'i shndërrojmë ato në mbrojtje të vërtetë, kujdes të vërtetë dhe mundësi të vërteta.

Sepse çdo fëmijë ka të drejtë për një fëmijëri.

Çdo fëmijë ka të drejtë për siguri.

Çdo fëmijë ka të drejtë për paqe.

Dhe çdo fëmijë meriton një të ardhme pa agresion, dhunë dhe frikë.

Përgatiti: Departamenti i promovimit të shëndetit dhe i ndjekjes së sëmundjeve